



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3364/6 prot

Datë 13.01.2026

V E N D I M

Nr. 57/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.01.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “*Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)*”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Gamma” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe vazhdim i procedurës së shqyrtimit

në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Ankimues: Operatori Ekonomik “Almedical” SHPK, me NUIS KK21511002I, me adresë Rruga Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Gamma” SHPK, me NUIS K31510153H, me adresë Njesia Administrative nr.8, Rruga Dervish Hekali, Ndertesa nr.8, Tirane.

Operatori Ekonomik “Krijon” SHPK, me NUIS K12023001A, me adresë Rruga e Elbasanit, Nr. 57, Çollak, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje

me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “*Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)*”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 12.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Krijon SHPK	5.928.800 lekë, skualifikuar
2. “Gamma” SHPK	7.700.000 lekë, skualifikuar
3. “ALMedical” SHPK	7.706.600 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK është skualifikuar nga KVO-ja me argumentat si më poshtë vijon:

“Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton: 3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. a) Ne kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk është përcaktuar paketimi me sasinë përkatëse për artikullin nr.2 (1,7 diaminoheptane) b) Ne kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar në paketim për artikujt: Nr.9 - Acid Citrik: është kërkuar shishe jo më e vogël se 100 mg dhe është ofruar shishe 10mg Nr.12-

Aflatoxine B1: është kërkuar paketim shishe/ampule sasi 5ml me përqëndrim 10mg/ml është ofruar 5.2ml me përqëndrim 10.03mg/ml Nr.13- Aflatoxine B1: është kërkuar shishe 3ml është ofruar shishe 5.2ml Nr.35-Ascorbic Acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar 250 mg Nr.76-Fructose: është kërkuar shishe jo më e vogël se 1000 mg është ofruar 250mg Nr.83 -Isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar në sasi 250mg Nr.86 -Maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000mg është ofruar në sasi 500mg Nr.116 -Sodium Cyclamate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar në sasi 250mg Nr.119 -Sodium saccharin: është kërkuar paketim jo më i vogël se 1g është ofruar në sasi 500mg Nr.120 -Sorbic Acid: është kërkuar paketim jo më i vogël se 1000mg është ofruar në sasi 250mg Nr.121 -Standart analitik glukozë: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar në sasi 250mg B. Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikujt të ofruar nga OE janë në sasi më të vogël nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë: (p.sh. për artikullin nr. 120 në DST kërkohet shishe 1000 mg ndërkohë që OE, referuar ofertës teknike të paraqitur ka ofertuar 250mg dhe në shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” ka ofertuar sasinë 1 shishe, Në këto kushte nuk plotësohen specifikimet teknike pasi 750 mg ngelen jashtë ofertës). Për sa më lartë OE skualifikohet për mospërbushje të kërkesave të vecanta për kualifikim, kapaciteti Teknik pikat 2.3.3.”

Operatori ekonomik “Gamma” SHPK është skualifikuar me argumentat si më poshtë vijon:
 “Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton:

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

a) Ne kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr.14 Aflatoxine totale (B1, B2, G1, G2), 10mg/ml, Acetonitrile 1ml/ampul OE ka ngarkuar produktin nga kompania prodhuese HPC Standart GmbH faqe 25,26,27, katalog Standarte loti pjesa 1, në të cilin produkti nuk ka 4 komponent sic kërkohej në DST por ka 5 komponent në përbërje përkatësisht (Aflatoxine B1, Aflatoxine B2, Aflatoxine G1, Aflatoxine G2, Ochratoxin A) duke tejkaluar specifikimet teknike të kërkuara.

b) Ne kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk janë të përcaktuara paketimet me sasi të përkatëse për artikujt nr. 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 38, 39, 64, 74, 76, 82, 85, 103, 104, 105, 112, 114, 119.

c) Ne kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar në paketim për artikujt:

Nr.12 - Aflatoxine B1: është kërkuar shishe/ampulë 5ml dhe është ofruar 1ml

Nr.13 - Aflatoxine B1: është kërkuar shishe 3ml është ofruar shishe 1ml

Nr.30 - Antigen BI, M41, HI: është kërkuar shishe 1ml është ofruar 0.5ml/mg

Nr.34 - Antiserum per Pseudopestin (ND) Ulster, HI: është kërkuar shishe jo më e vogël se 1ml është ofruar shishe 0.5 ml

Nr.36 - Aspartame: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1gr është ofruar 500 mg

Nr.37 - Azorubine (Carmoisine): është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 50 mg është ofruar 25mg

Nr.66 - Dihydrosteptomycin sulphate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200gr është ofruar 100 gr

Nr.81 - histamine dihydrochloride: është kërkuar shishe 10g është ofruar 250mg

Nr.83 - Isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar në sasi 250mg

Nr.116 - Sodium Cyclamate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500mg është ofruar në sasi 250mg

Nr.120 -Sorbic Acid: është kërkuar paketim jo më i vogël se 1000mg është ofruar në sasi 250mg

Nr.122-Standar sucralose: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg është ofruar 100mg

B. Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikujt të ofruar nga OE janë në sasi më të vogël nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë: (p.sh. për artikullin nr. 120 në DST kërkohet shishe 1000 mg ndërkohë që OE, referuar ofertës teknike të paraqitur ka ofertuar 250mg dhe në shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” ka ofertuar sasinë 1 shishe, Në këto kushte nuk plotësohen specifikimet teknike pasi 750 mg ngelen jashtë ofertës).

Për sa më lartë OE skualifikohet për mospërmbushje të kërkesave të vecanta për kualifikim.

Operatori ekonomik “Krijon” SHPK është skualifikuar me argumentat si më poshtë vijon:

“A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

a. OE nuk ka sjell katalog për produktin nr. 44 përkatësisht Nr.44- Buffer PH 7.0

b. Në kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk janë të përcaktuara paketimet me sasi të përkatëse për artikujt nr.1, 2, 5, 6, 9, 10,11, 28, 30, 31, 36,47,49,58, 69, 71, 76, 80, 102,106, 108, 112, 114, 119, 121, 123, 125, 126,127,128,129,130,131.

c. Në kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar në paketim për artikujt:

Nr.13- Alfatoxine M1: është kërkuar ampulë 3ml dhe është ofruar ampulë 2ml

Nr.42-Buffer pH 9.21: është kërkuar shishe 500ml është ofruar shishe 1000 ml

Nr.66 Dihydrosteptomycin sulphate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200gr është ofruar 100 gr

Nr.83-Isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg është ofruar 250mg

Nr.86 -Maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000mg është ofruar në sasi 500mg

d. Në kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr.14 Aflatoxine totale (B1,B2,G1, G2), 10mg/ml, Acetonitrile 1ml/ampul OE ka ngarkuar produktin nga kompania prodhuese Cyaman Chemicals faqe 29,30,31, katalog 1-30 në të cilin produkti nuk ka 4

komponent sic kerkohet ne DST por ka 5 komponent ne përbërje përkatësisht (B1, B2, G1, G2, A) duke tejkaluar specifikimet teknike të kërkuara.

B. OE nuk plotëson Pikën 2.3.5 të KVK e cila përcakton

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga Distributor i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr. rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 47, 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te veçantë.

OE nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi TRC (Toronto Research Chemicals) për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim.

C. Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikujt të ofruar nga OE janë në sasi më të vogël nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë: (p.sh. për artikullin nr. 83 në DST kërkohej shishe 500 mg ndërkohë që OE, referuar ofertës teknike të paraqitur ka ofertuar shishe 250 mg dhe në shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” ka ofertuar sasinë 1 shishe.

Në këto kushte nuk plotësohen specifikimet teknike pasi 250 mg ngelen jashtë ofertës).

Për sa më lart OE skualifikohet për mospërbushje të kërkesave të vecanta për kualifikim.”

II.3. Në datën 13.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 20.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6108 dhe nr. 3364/2025 protokoli, datë 21.11.2025 e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]

Kompania jone është kualifikuar për mospërbushje të specifikimeve teknike për artikujt Nr : 2,9,12,13, 35,76 ,83,86,116,119, 120,121.

Për artikullin nr 2 pretendohet që nuk përmbushet specifikimi teknik mbi njesinë.

Konkretisht në DST kërkohej që : 2 .1,7 diaminoheptane Standard i brendshëm; C₇H₁₈N₂, shishe 25g, me pastërti =98%, shoqëruar me certifikate analitike.

Kompania jone ka prezantuar artikullin e kompanisë Sigma me kod D17408-25G

Kodet e kësaj kompanie e shprehin në kod njesinë 25 G dhe lehtësisht mund të verifikohet edhe në webin zyrtar të kësaj kompanie ndaj kompania jone përmbush specifikimin teknik në lidhje me këtë artikull.

<https://ëëë.sigmaaldrich.com>

Ne lidhje me artikullin nr 12 pretendohet qe nuk permbushet specifikimi teknik ne lidhje me perqendrimin. Nga 10mg/l qe kerkohet ne kemi ofertuar 10.03 mg/l. Ky pretendim nuk qendron sepse standartet analitike kane zakonisht tolerance $\pm 2-5\%$. Standarti i ofruar me vlere te certifikuar 10.03 rrumbullakoset ne 10 dhe perputhet plotesisht me kerkesen ne DST. Devijimi prej 0.03 eshte brenda devijancave dhe nuk perben asnje problem per qellime analitike. Produkti eshte tekniksht i sakte dhe ne perputhje me specifikimet.

Ndersa ne lidhje me artikujt tjere pretendohet qe nuk permbushet njesia.

Kompania jone ka ofertuar njesi me te vogla paketimi por ploteson sasine totale. [...].

Paketimi nuk prek funksionin e artikujve ky arsyeja e skualifikimit per mospermbushje te specifikimeve teknike nuk qendron. Kompania jone ka ofertuar njesi me te vogla qe te plotesoje sasine totale te kerkuar.

Keshtu per artikujt si me poshte :

Artikulli 9

9. Acid citrik Standart analitik CAS 77-92-9, Pastertia =99% pluhur i imEt, Shishe sasia jo me e vogel se 100 mg, e shoqeruar me certifikate analitike- shishe 1

Kompania jone ka ofertuar artikullin nga kompania LGC me njesine 10 mg x 10 shishe ne total 100 mg

Artikulli 13

13 Aflatoxine M1. Solucion standart me perqendrim 1?g/ml (.I tretur ne acetonitril), paketim origjinal (ampule) e shoqeruar me certifikate analitike.sasia totale 3ml shishe 1

Kompania jone ka ofertuar shishe 5.2 ML. Nuk mund te skualifikosh per njesi te ofruar me teper, AK mund te perdore sasine qe i duhet.

Artikulli 35

35 Ascorbic acid Standart analitik CAS 50-81-7, shishe sasia jo me e vogel se 500 mg, I pershtashem per HPLC, e shoqeruar me certifikate analitike shishe 1

Kompania jone ka ofertuar 250 mg 2x250 mg =500 mg

Artikulli 76

76 Fructose CAS 57-48-7, standart fruktoze, pastertia = 99 % , pluhur, shishe sasia jo me e vogel se 1000 mg, e shoqeruar me certifikate analitike shishe 1

Kompania jon e ka ofertuar 250 mg 4x250 mg =1000 mg

Artikulli 83

83 Isoascorbic acid Standart analitik CAS 89-65-6, cristalin me pasterti =98%, shishe sasia jo me e vogel se 500 mg , e shoqeruar me certifikate analitike shishe 1

Kompania jon e ka ofertuar 250 mg 2x250 mg =500 mg

Artikulli 86

86 Maltitol Standart analitik CAS 585-88-6, standart analitik maltitol. Pastertia = 99 % , Pluhur.

Shishe sasia jo me e vogel se 1000 mg, e shoqeruar me certifikate analitike shishe 1

Kompania jone ka ofertuar 500 mg 2x500 mg =1000 mg

Artikulli 116

116 Sodium cyclamate Standart analitik.CAS 139-05-9, pasterti =98.0% , shishe me paketim sasia jo me e vogel se 500 mg , e shoqeruar me certifikate analitike shishe 1

Kompania jone ka ofertuar 250 mg 2x250 mg =500 mg

Artikulli 119

119 Sodium saccharin Standart analitik.CAS 128-44-9, I pershtatshem per HPLC me paketim sasia jo me e vogel se 1 g, e shoqeruar me certificate analitike shishe 1

Kompania jone ka ofertuar 500 mg 2x500mg =1000 mg ose 1 g

Artikulli 120

120 Sorbic acid Standart analitik.CAS 110-44-1 , pasterti = 99.% paketim sasia jo me e vogel se 1000 mg, e shoqeruar me certificate analitike. shishe 1

Kompania jone ka ofertuar 250 mg 4x250 mg =1000 mg

Artikulli 121

121 Standart analitik glukoze CAS 50-99-7, standart analitik glukoze, PastErtia = 99 % , Pluhur.

Shishe sasia jo me e vogel se 500 mg, e shoqeruar me certificate analitike shishe 1dx4

Kompania jone ka ofertuar 250 mg 2x250 mg =500 mg

Pretendimi i AK qe ne oferten ekonomike per shkak te ofertes teknike me njesi me te vogla; jane ofertuar me pak sasi nuk qendron sepse kompania jone ka dhene oferte per sasine total qe kerkon AK por ne njesine qe ne kemi prezantuar.

Bazuar ne sa me siper kompania jone kerkon kualifikimin e kompanise sone sepse refuzimi nuk mbeshtetet ne argumenta teknik apo ligjore.”

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3364/1 prot, datë 25.11.2025 me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.3364 prot.

II.4.2. Në datat 05.12.2025 dhe 09.12.2025 janë protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik përkatësisht me nr. 3364/2 prot., dhe 3364/3 prot., vendimi i KSHA-së nr. 4105 prot., datë 04.12.2025 dhe shkresa nr. 4105/1 prot., datë 05.12.2025 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “ALMedical” shpk, “Krijon”shpk dhe “Gamma” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: Loti 1 “Blerje standarte”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (I3UV)”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimesit janë pranuar plotësisht nga ky komision.

II.5. Në datën 24.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6120 dhe nr. 3378/2025 protokoli, datë 25.11.2025 e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Gamma” SHPK, si dhe ngrihen pretendime për ofertën e paraqitur nga shoqëria “Krijon” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]

Bazuar ne nenin 110/2 te Ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se “2. Ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar, ne rastin e ankesave per vendimin e vleresimit/klasifikimit perfundimtar, operatoret ekonomike kane te drejte te ankohen brenda 10 diteve nga publikimi i njoftimit te fituesit ose publikimi i njoftimi te anulimit. Ne procedurat e prokurimit nen kufirin e larte monetar ky afat eshte 7 dite” dhe nenin 97/2/b te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “2. Ne rastin e ankesave per vendimin e vleresimit/klasifikimit perfundimtar, operatoret ekonomike mund te ankohen prane autoritetit/entit kontraktor: b) brenda 7 (shtate) diteve nga publikimi i njoftimit te fituesit, ose publikimi i njoftimit te anulimit, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e larte monetare po paraqesim kete formular ankese duke kerkuar kualifikimin e ofertes tone dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit te OE Krijon shpk.

Ne lidhje me artikullin 14 - Aflatoxine totale (B1, B2, G1, G2) 10 mg/ml, sqarojme se ne faqen 27 te katalogut teknik eshte percaktuar qarte nga kompania prodhuese se produkti i ofruar nuk permban Ochratoxin A. Kjo do te thote se produkti eshte plotesisht ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST, dhe cdo pretendim per mosperputhje eshte i pabazuar. Bashkëngjitur faqet e katalogut të paraqitura në SPE për këtë produkt.

Sa i perket arsyeve te skualifikimit qe lidhen me konfeksionet, vleresojme se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer nje analize te plote dhe objektive te ofertes sone teknike, sic kerkohet nga neni 68, pika 4 e Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku percaktohet se:

“Autoriteti kontraktor, ne rast pasigurie ose paqartesie ne lidhje me permbajtjen e ofertes, mund te kerkoje sqarime me shkrim nga operatori ekonomik perkates.”

Ne kete rast, nje kerkese e tille per sqarim do te kishte qene e mjaftueshme per te sqaruar se oferta jone eshte dhene saktesisht sipas sasise se kerkuar ne DST.

Per shembull, nese ne DST per artikullin nr. 120 kerkohet 1000 mg, ndersa ne katalogun teknik te paraqitur nga ne eshte specifikuar konfeksion prej 250 mg, ne oferten ekonomike eshte ofertuar per 4 konfeksione nga 250 mg, pra per sasine e plote 1000 mg, cmimi i ofertuar eshte llogaritur ne menyre te drejte per kete sasi, dhe kjo tregon qarte perputhshmerine e plote me kerkesat teknike.

Ky argumentim shkon per te gjithë produktet 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 38, 39, 64, 74, 76, 82, 85, 103, 104, 105, 112, 114, 119, 12, 13, 30, 34, 36, 37, 66, 81, 83, 116, 120, 122.

Sipas shenimit te dhene ne DST shenim: per cdo certifikate, standard, marke, emer i vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres te permendur me lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre. Kuptohet se lejohet ofrimi i konfeksioneve (produkteve) ekuivalente, per sa kohe plotesojne kerkesat teknike dhe funksionale te tenderit. Kjo perben nje detyrim ligjor qe AK te pranoje produkte te barasvlershme, edhe nese ato devijojne nga emertimet, markat apo konfeksionet (paketimet) e permendura ne specifikimet teknike.

Per me teper, neni 2, pika 23 ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” thekson parimin e trajtimeve te barabarta dhe konkurrenca se ndershme, ndersa neni 5 percakton parimin e efikasitetit dhe proporcionalitetit ne vleresim. Ne kete rast, mosmarrja ne konsiderate e elementeve te qarta ne katalogun teknik dhe moskerkimi i sqarimeve perbejne shkelje te ketyre parimeve themelore. Gjithashtu, duke qene se kompania jone ka marre pjese, ka fituar dhe ka plotesuar me sukses disa here procedura te ngjashme nder vite, si ne Institutin e Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise dhe ne Ministrine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, ne zoterojme eksperience te konsoliduar ne interpretimin dhe ofertimin e konfeksioneve sipas kerkesave te DST. Per me teper, eshte paraqitur ne sistem sigurimi i ofertes, cka tregon qarte angazhimin dhe garancine tone qe produktet do te furnizohen 100% sipas sasise se kerkuar ne dokumentet e tenderit.

Vendime te ngjashme per ekuivalence te konfeksioneve KPP ka dhene dhe me perpara, si psh. Vendimi Nr. 446/2023 dhe Vendimi Nr. 473/2024, ku percaktohet se specifikimet teknike kane synim kryesor qe t’i sherbejne AK per sigurimin e produktit sa me cilesor, me qellim realizimin me sukses te kontrates dhe permbushjen e nevojave. Ne rastin konkret nje paketim me i vogel por qe ne total ploteson nevojat e AK, eshte me rezistent, ka jetegjatesi me te madhe dhe perdorime me te shumta per AK. Sipas dokumenteve te tenderit, per cdo specifikim teknik ku permendet nje marke, standard ose permasa, pranohet edhe “ekuivalenti i tyre”.

Komisioni i Prokurimit Publik ka theksuar qarte se specifikimet teknike duhet te lejojne trajtim te barabarte dhe nuk duhet te sherbejne si pengese per konkurrenca (shih Vendimin KPP Nr. 301). Per me teper, KPP ka shfuqizuar me pare vendime te komisioneve te vleresimit te ofertave kur keto i kane interpretuar ne menyre tejet strikte kriteret teknike (shembuj: vendimet Nr. 842/2022 dhe Nr. 1441/2024). Nga kjo rrjedh se nje ndryshim ne permasa fizike nuk duhet te perdoret automatikisht si shkak skualifikimi, nese oferta permbush sasine, funksionin dhe performancen e kerkuar; ne rastin konkret, ne kemi paraqitur konfeksione qe, megjithese individualisht me te vogla, plotesojne sasine totale dhe vleren ekonomike te kerkuar. Per keto arsye, kerkojme rishqyrtimin e vendimit te skualifikimit. Ne keto kushte, skualifikimi yne eshte i pabazuar ne fakte dhe ne kundërshtim me parimet dhe dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik.

Ne baze te nenit 63, pika 1 te Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, cdo operator ekonomik ka te drejte te paraqese ankese jo vetem per veprimet ose mosveprimet qe lidhen drejtpërdrejt me oferten e tij, por edhe per ofertat e operatoreve te tjere pjesemarrës, kur keto ndikojne ne rezultatin perfundimtar te vleresimit.

Duke u mbështetur ne kete dispozite ligjore, dhe duke qene se kompania jone ka eksperience shumevjecare ne kete fushe, jemi ne dijeni te kompanive qe operatorët konkurrues mund te kene perdorur ne ofertat e tyre.

Ne kete kuader, vleresojme se pervec arsyeve te permendura nga Autoriteti Kontraktor, eshte e nevojshme te theksohet se kompania “Krijon” sh.p.k, mund te kete ofruar produkte ne artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112, te cilat nuk jane standarde analitike sipas kerkesave te percaktuara ne DST, por reagente te zakonshem laboratorike.

Eshte e rendesishme te nenvizohet se dallimi ndermjet nje reagenti dhe nje standardi analitik eshte thelbesor ne aspektin shkencor dhe teknik:

? Reagenti perdoret per kryerjen e reaksioneve kimike ose pergatitjen e mostrave;

? Ndersa standardi analitik eshte nje substance e testuar dhe e certifikuar, qe sherben per kontrollin e saktetise dhe precizionit te analizave laboratorike.

Per kete arsye, cmimi dhe cilesia e nje standardi analitik jane dukshem me te larta krahasuar me nje reagent te thjeshte, dhe zevendesimi i njerit me tjetrin perben devijim nga specifikimet teknike te parashikuara ne DST.

Gjithashtu, per produktet me numer rendor 12, 13, 14 dhe 47, operatori ne fjale mund te mos kete paraqitur Autorizimin e Prodhuesit, dokument i cili eshte obligim ligjor sipas nenit 45 te VKM nr. 914, date 29.12.2020, "Per zhvillimin e procedurave te prokurimit publik" dhe piken 5 te Kriterit te Vecante te Kualifikimit - Kapaciteti Teknik, qe kerkon qe ofertuesi te provoje marredhenien zyrtare me prodhuesin ne rastet e produkteve specifike laboratorike.

Per rrjedhoje, duke u bazuar ne faktet dhe argumentet e mesiperme, si dhe ne dispozitat perkatese te Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" dhe te VKM nr. 914/2020, operatori ekonomik "Krijon" sh.p.k duhet te qendroje i skualifikuar, pasi mendojme qe oferta e tij nuk permbush kerkesat ligjore dhe teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe eshte ne kundërshtim me parimet e barazise, transparences dhe konkurrences se ndershme.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3378/1 prot, datë 26.11.2025 me arsyet e skualifikimit të shoqërisë "Gamma" SHPK si dhe pretendimet e ngritura prej tij lidhur me ofertën e shoqërisë "Krijon" SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.3378 prot.

II.5.2. Në datën 02.12.2025 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr. 3378/2 prot., Formulari i paraqitjes së argumentave me pretendime nga operatori ekonomik i interesuar "Krijon" SHPK si më poshtë vijon:

"Së pari, referuar legjislacionit të prokurimit publik, Shoqëria "Krijon" sh.p.k ka "prima facie" interes për të paraqitur argumente për ankesën e paraqitur kundër saj në këtë procedurë prokurimi, pasi është operator ekonomik i interesuar, interesi i ligjshëm i të cilit çënohet nga ankesa e operatorëve të tjerë ekonomikë, si dhe nga veprimet që autoriteti kontraktor mund të marrë bazuar në këto ankesa.

Së dyti, referuar nenit 113 të LPP, pika 2 "Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.”, Shoqëria “Krijon” sh.p.k dërgon argumentet në përputhje me afatin e përcaktuar ligjor.

Në datën 01.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Loti 1: REF-63098-09-30-2025, me objekt: Loti 1: “Blerje standarte”, me fond limit 8,958,264 (tetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe datë zhvillimi 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara sh.a.

Në datën 12.11.2025 u publikua në SPE klasifikimi i tenderit, ku citohej se oferta jonë ishte refuzuar.

Në datën 13.11.2025 u njohëm nëpërmjet SPE se procedura e prokurimit u anulua për arsye se nuk u gjet asnjë ofertë e përshtatshme.

Në datën 26.11.2025 jemi njohur me Formularin për Publikim ndërmjet databazës së të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili informon se është dërguar ankesë nga shoqëria “Gamma” sh.p.k e cila kërkon skualifikimin e shoqërisë Krijon shpk.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se kompania Krijon shpk mund të ketë ofruar produkte në artikujt nr. 2,79,111 dhe 112 të cilat nuk janë standarte analitike sipas kërkesave të përcaktuara në DST, por reagentë të zakonshëm laboratorike. Gjithashtu pretendohet se produktet me numër rendor 12, 13, 14 dhe 47 shoqëria Krijon shpk mund të mos ketë paraqitur autorizim prodhuesi.

Operatori ekonomik Gamma shpk ngre pretendime a-priori dhe keto pretendime janë të pabazuara në dokumente dhe fakte konkrete, por vetëm mbi hamëndësime dhe dëshirën e ankuesit për të skualifikuar operatorin “Krijon” shpk, i cili vetëm ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nga vetë formulari për publikim ku citohen fjalët “mund” operatori ekonomik ankimes ka bërë ankesë të pa bazuar në prova dhe fakte.

Sjellim në vëmendje të Komisionit të Prokurimit Publik se ankesa e operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k është spekulativ dhe në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik. Konkretisht, sipas ligjit nr. 162/2022, datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 111, pika 2 “Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”, një nga kriteret që duhet të plotësojë një ankesë në mënyrë që të merret në shqyrtim nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik është paraqitja e provave dhe jo vetëm bazuar në hamëndësime apo pretendime të pabazuara shkresërisht.

Referuar nenit 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” parashikohet se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj” shoqëria Gamma shpk nuk zotëron asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij.

Pretendime pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta mbi elementët përbërës të ofertës

së konkurentit të kualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është abuziv dhe në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik.

Referuar vendimit të Komisionit të prokurimit Publik nr.596/2018 datë 12.09.2028 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të prokurimit Publik, KPP shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrative dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit të afateve) edhe elementët e domosdoshëm të ankesës:

- Ankesa sipas rastit shoqërohet me provat dokumentare të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni.

Nga sa më sipër, theksojmë se KPP është organi më i lartë administrativ i cili shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra KPP në rastin kontret nuk mund të marrë tagrin e KVO dhe të hetojë dhe verifikojë në themel lidhur me një pretendim abstrakt.

Theksojmë se Shoqëria “Krijon” sh.p.k ka dorëzuar të gjithë dokumentet, në përputhje të plotë me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në përfundim të argumentimit, kërkojmë që ankesa e shoqërisë “Gamma” shpk të mos merret parasysh.”

II.5.3. Në datën 05.12.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3378/3 prot., shkresa nr. 4105/1 prot., datë 05.12.2025 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “AlMedical” shpk, “Krijon” shpk dhe “Gamma” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: Loti 1 “Blerje standarte”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (I3UV)”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr. 144/2025, datë 04.12.2025. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë pranuar pjesërisht nga ky komision. Konkretisht janë pranuar plotësisht pretendimet e ankimuesit, sa i përket skualifikimit të padrejtë të shoqërisë “Gamma” SHPK. Sa i përket pretendimeve të ankimuesit për shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Krijon” SHPK rezulton se autoriteti kontraktor i ka pranuar pjesërisht ato, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Gamma” shpk mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e dorëzuar nga shoqëria “Krijon” shpk duke pretenduar se “[...] kompania “Krijon” sh p k. mund të ketë ofruar produkte në artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112, të cilat nuk janë standarde analitike sipas kërkesave të përcaktuara në DST, por reagentë të zakonshëm laboratorikë. [...] Gjithashtu, për produktet me numër rendor 12, 13, 14 dhe 47, operatori në fjalë mund të mos ketë paraqitur Autorizimin e Prodhuesit, dokumeni i cili është obligim ligjor sipas nenit 45 të VKMnr. 914, datë 29.12.2020, Për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe pikën 5 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, që kërkon që ofertuesi të provojë marrëdhënien zyrtare me prodhuesin në rastet e produkteve specifike laboratorike.”, KSHA vëren se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 3 është përcaktuar se “3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara

sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertën. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemin elektronik të prokurimit.”

2	1,7 diaminoheptane	Standard i brendshëm; C ₇ H ₁₈ N ₂ , shishe 25g, me pasteriti 98%, shoqeruar me certificate analitike	shishe	1
75	Glyceryl 1,3-distearate	Standart analitik CAS 504-40-5, pasterti 99.0%, shishe sasia jo më e vogël se 100mg, e shoqeruar me certificate analitike	shishe	2
111	Ponceau 4R	Standart analitik CAS 2611-82-7, pasterti per >98% , shishe sasia jo më e vogël se 25 mg, e shoqeruar me certificate analitike	shishe	2
112	Potassium nitrate	Standart analitik Me pasterti, 99.0% shishe me paketim sasia jo më e vogël se 100 mg, e shoqeruar me certificate analitike	shishe	1

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik “Krijon” shpk në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Thermo Fisher Scientific (katalog 1-30; faqe 2) ku përcaktohet:
 - Emërtimi i dokumentit: “Certificate of Analysis” — Certifikatë Analize/Raport Analizë;
 - Catalogue number: 11220
 - Description: 1,7 diaminoheptane, 98%
 - CAS Number: 646-19-5
- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Sigma-Aldrich (katalog 61 -9 l; faqe 41) ku përcaktohet:
 - Emërtimi i dokumentit “Product Specification” — Specifikimet e Produktit;
 - Product Name: Glyceryl 1,3-distearate ≥ 99.0%
 - Product number: D8269
 - CAS Number: 504-40-5
- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese DR. Ehrenstorfer (katalog 92-115; faqe 30-31-32) ku përcaktohet:
 - Emërtimi i dokumentit: “Certificate of Analysis” — Certifikatë Analize/Raport Analizë
 - Product Name: Ponceau 4RC (E124)
 - Product Code: DRE-C16284000
 - CAS Number: 2611-82-7
- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese DR. Ehrenstorfer (katalog 92-115; faqe 33) ku përcaktohet:
 - Emërtimi i dokumentit: “Certificate” — Të dhëna teknike/kimike
 - Product Name: Potassium Nitrate
 - USP Catalog No.: 1548349
 - USP Lot No.: R l53G0
 - CAS Number: 7757-79-1

[...]Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPA nga operatori ekonomik “Krijon” shpk, KSHA vëren se ky i fundit, lidhur me përmbushjen e kriterit 2.3.3 të sipërcituar, për artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112 ka paraqitur fletë nga katalogët e prodhuesve

përkatës me emërtimin "Certificate of Analysis" - Certifikatë Analize, e cila në vetvete rezulton të jetë një Raport Analizë për artikujt përkatës. Nga ana tjetër KSHA vëren se në specifikimet teknike të përcaktuara në DT, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që këto produkte "Standarde Analitike" të shoqërohen edhe me Certifikatë Analitike ose (CRM) Certified Reference Material. Duke i'u referuar objektit të prokurimit "Loti 1. "Blerje standarte", Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)", KSHA konstaton se nga ana e operatorit ekonomik "Krijon" shpk nuk është dorëzuar dokumentacioni i plotë sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në specifikimet teknike të DT pasi, ai nuk ka shoqëruar produktet e sipërcituara me një Certified Reference Material, por thjesht me një Raport Analizë, e rrjedhimisht duke mos plotësuar kriterin e sipërcituar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

Për sa me sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Gamma" shpk lidhur me ofertën e shoqërisë "Krijon" shpk **qëndrojnë**.

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 5 është përcaktuar se "5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr. rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 4 , 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te vecantë."

12	Aflatoxine Bl	Standart analitik solucion , me përqendrim 10 {ig/mL ne acetonitrile, paketim shishe/ampule, sasia totale 5 ml,	shishe	1
13	Afiatoxine MI.	Solucion standart me perqendrim 1 pg/ml (.I tretur ne acetonitril), paketim origjinal (ampule) e shoqeruar me certifikate analitike.sasia totale 3ml	shishe	1
14	Aflatoxine Totale .	Aflatoxins (B1, B2, GI, G2) , 10 pg/mL, Acetonitrile, I mL/ampul.	shishe	2
47	CRM AZA 3	Material Reference i Certifikuar AZA 3 eshte nje solucion kalibrues per percaktimin e Azaspiracid-3 (AZA3) nepermjet metodave kimike analitike. I tretur ne metanol, me perqendrim jo me pak se 1.32ug/g. Cdo ampule ka 0.5 mL, shoqeruar me certifikate analitike. Nga NRC Kanada ose ekuivalent.	ampule	6

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik "Krijon" shpk në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Trilogy (katalog 1-30) ku përcaktohet:
- Aflatoxine B 1, me përqendrim 10 pg/ml në acetonitrile, sasia totale 5 ml, (faqe 24-25);
- Aflatoxine MI, me përqendrim 1 pg/ml në acetonitrile, sasia totale 3ml (faqe 26-27);
- Autorizim Prodhuesi nga Kompania prodhuese Trilogy Analytical Laboratory me listën e produkteve qe prodhon kjo kompani:
- Naturally Contaminated Reference Material

- Reference Standards in liquid form, (Aflatoxin in Acetonitrile)
- Reference Standards in dried form
- Solid Phase Extraction Purification Columns (QP1000 & QP 1100)
- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese NRC-CNRC (katalog 31-60) ku përcaktohet:
- Material Reference i Certifikuar Azaspiracid-3 (AZA3), i tretur në metanol, me përqendrim 1.51 pg /g.
- Dokument/shkresë reference nga Kompania prodhuese National Research Council Canada (NRC) për shoqërinë Krijon shpk.

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Krijon” shpk, KSHA konstaton se, lidhur me produktet Afiatoxine B1 dhe Aflatoxine M1 është paraqitur Autorizimi i Prodhuesit “Trilogy Analytical Laboratory”, i cili përmban të gjithë elementët përkatës në përputhje me kriterin 2.3.5 të sipërcituar.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues “Gamma” shpk lidhur ne ofertën e shoqërisë “Krijon” shpk **nuk qendron**.

Sa i takon produktit nr. 47 “Azaspiracid-3 (AZA3)” shoqëria “Krijon” shpk ka paraqitur Fletë katalogu nga Kompania prodhuese NRC-CNRC si dhe një dokument letër reference, ku kompania prodhuese NRC vlerëson pozitivisht bashkëpunimin me këtë shoqëri, por pa dhënë asnjë element autorizues lidhur me produktet që ajo prodhon e për më tepër lidhur me artikullin nr. 47 Material Reference i Certifikuar Azaspiracid-3 (AZA3), i tretur në metanol, me përqendrim 1.51 pg /g. Rrjedhimisht ky dokument nuk mund të konsiderohet një Autorizim Prodhuesi, duke mos plotësuar kriterin e sipërcituar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues “Gamma” shpk lidhur me ofertën e shoqërisë “Krijon” shpk **qëndron**.

II.5.4. Në datën 22.12.2025, nëpërmjet shkresës nr. 3378/4 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion, shoqëruar me dokumentacionin provues, lidhur me njoftimin e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, sa i takon vendimarrjes së KSHA-së, për sa i përket pretendimeve të ngritura nga ana e shoqërisë “Gamma” SHPK për shoqërinë “Krijon” SHPK.

II.5.5. Në datën 31.12.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3378/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.4251/10 prot., sarë 29.12.2025 me objekt: “Kthim përgjigje”. Me anë të kësaj shkrese autoriteti kontraktor informon se: “Në datën 05.12.2025, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA ka dërguar pranë KPP-së dhe operatorëve ekonomikë ankimues “AlMedical” SHPK, “Krijon” SHPK dhe operatorit ekonomik ankimues “Gamma” SHPK vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.144/2025, datë 04.12.2025, me shkresën përcjellëse nr. 4105/1 prot., datë 05.12.2025 “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Almedica” SHPK, “Krijon” SHPK dhe “Gamma” SHPK, për vlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit. Nga dërgimi i vendimit dhe deri në momentin e administrimit të kërkesës suaj me nr. 3378/4 prot., datë 22.12.2025, ju informojmë se organi qendror blerës nuk ka marrë asnjë komunikim zyrtar nga Posta Shqiptare SHA mbi problematika të hasura ose kthimin e objektit postar në fjalë.” Bashkëngjitur kësaj shkrese autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP faqen e librit të

protokollit, të njoftimit nëpërmjet shërbimit postar, të shoqërisë “Krijon” SHPK, me datë 05.12.2025.

II.6. Në datën 24.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6122 dhe nr. 3380/2025 protokoli, datë 25.11.2025 e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]Skualifikimi i ofertës ekonomike të shoqërisë “Krijon” sh.p.k. është i pabazuar në legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik dhe në të njëjtën kohë arsyet e skualifikimit janë të pamotivuara nga faktet dhe dokumentet e dorëzuara Autoritetit Kontraktues.

Për të vërtetuar pretendimin tonë, ju argumentojmë si vijon:

1. Referuar arsyes së skualifikimit: OE nuk ka sjell katalog për produktin nr.44 përkatësisht Nr.44 Buffer PH 7.0.

Arsyeja e skualifikimit paraqitur nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara nuk bazohet në fakte dhe prova. Shoqëria Krijon shpk pikërisht për këtë artikull ka paraqitur katalogun me emërtimin “ Katalog 31-60”, konkretisht faqet të cilat janë deklaruar edhe në ofertën teknike (faqe 28,29,30,31). Artikulli nr. 44 Buffer PH 7.0 është markuar me të verdhë me kodin 32096.291, cili gjithashtu është i deklaruar në ofertën teknike

Pavarësisht faktit që Autoriteti Kontraktues ka administruar katalogun dhe ofertën teknike, sjellim në vëmendje se referuar nenit 82 të VKM “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nëse është e nevojshme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilat duhet të jenë më shkrim dhe të pasqyruara në procesverbal.

2. Referuar arsyes së skualifikimit. Në katalogët e markuar në SPE nga operatori nuk janë të përcaktuara paketimet me sasi të përkatëse për artikujt nr. 1,2,5,6,9,10,11,28,30,31,36,47,49,58,69,71,76,80,102,106,108,112,114,119,121,123,125,126, 127,128,129,130,131.

3. Referuar arsyes së skualifikimit: Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar ampulë 3ml dhe është ofruar ampulë 2ml nr.42 – buffer ph 9.21. është kërkuar shishe 500 ml është ofruar shishe 1000ml nr. 66 dihydrosteotomycin sulphate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200 gr është ofruar 100 gr Nr.83 isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg është ofruar 250mg nr. 86 maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000 mg është ofruar në sasi 500 mg.

Nga sa më sipër, gjykojmë se Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka vendosur skualifikimin e ofertës tonë në kundërshtim me ligjin që rregullon prokurimet publike.

Së pari, skualifikimi nga një procedurë prokurimi me arsyetimin se nuk është markuar apo respektuar paketimi i artikujve është i pabazuar në ligj.

Së dyti, shoqëria Krijon shpk ka siguruar autoritetin kontraktues nëpërmjet deklaratës ngarkuar në SPE, se pavarësisht paketimit të kërkuar në DST për të gjithë artikujt, marrim përsipër që të furnizojmë të gjithë sasinë e kërkuar të artikujve objekt prokurimi. Deklarata përbën angazhim real dhe konkret të operatorit i cili merr përsipër furnizimin e artikujve sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjitha artikujt ku është kërkuar që paketimi të vijë origjinal dhe hermetik nga prodhuesi, do të furnizohen të pa hapura dhe në gjendjen fizike sipas kërkesës dhe kushteve të ruajtjes.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se do të furnizojë të gjithë sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktues pavarësisht paketimit që ka prodhuesi.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjithë artikujt e kërkuar do të jenë të shoqëruara me certifikatat e analizave nga prodhuesi.

Në shumë vendime të KPP citohet se operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktues, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara në mënyrë që AK të mund të kryejë me lehtësi dhe saktësi vlerësimin e mallrave apo shërbimeve të ofertuar nga OE pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi

Së treti, qëllimi themelor i autoritetit kontraktor është furnizimi me mallra cilësorë, me siguri dhe kualitet. Krijon shpk ka siguruar pikërisht këtë – mallrat do të dorëzohen pa kompromentuar cilësinë, dhe pa prishur paketimin për të shmangur rrezikun e dëmtimit, gjë që tregon fleksibilitet dhe kapacitet profesional për realizim me sukses të kontratës.

4. Referuar arsyes së skualifikimit Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr. 14 aflatoxine totale (B1,B2,G1,G2), 10 mg/ml, Acetonitrile 1 ml/ampul OE ka ngarkuar produktin nga kompania Cayman Chemicals faqe 29,30,31, katalog 1-30 në të cilin produkti nuk ka 4 komponent sic kërkohet në DST por ka 5 komponent në përbërjen përkatësisht (B1,B2,G1,G2,A) duke tejkalluar specifikimet teknike të kërkuara.

Referuar procesverbalit të argumentimit “Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar),

5.Referuar arsyes së skualifikimit OE nuk plotëson pikën 2.3.5 të KVK e cila përcakton: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, për artikujt me nr. rendor

4,5,6,9,10,12,13,14,27,31,33,37,39,47,67,70,78 dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi të vecantë. OE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi TRC për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim.

Së pari, TRC (Tornoto Research Chemicals) është pjesë e kompanisë LGC.

Së dyti, në autorizimin e dorëzuar në SPE nga kompania LGC janë të cituar të gjithë artikujt për të cilat shoqëria Krijon shpk autorizohet të tregëtojë dhe të paraqesë ofertë, ndër këto është edhe artikulli nr. 9 Acid Citrik me kod C521000-1G. Kodi i cituar është edhe tek oferta teknike. Do të ishte e pamundur që një kompani prodhuese (LGC) të specifikonte në një autorizim të dhënë produkte të cilat nuk do i furnizonte ajo vetë.

Nëse Operatori i Blerjeve të Përqendruara do të kishte paqartësi lidhur me autorizimin e prodhuesit, në këtë rast të LGC ku duken qartë artikujt – kodet për të cilat autorizon, mund të kishte kontaktuar në adresat e shënuara në autorizim.

Në një kërkim të thjeshtë në faqen e web-it të kompanisë LGC informohesh se TRC dhe disa kompani të tjera janë pjesë e LGC. Bashkëngjitur dokumentacionin për verifikimin e faktit marrë në faqet e web-it të kompanive TRC dhe LGC.

Referuar nenit 82 të VKM “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nëse është e nevojshme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilat duhet të jenë më shkrim dhe të pasqyruara në procesverbal.

6.Referuar arsyes së skualifikimit Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikuj të ofruar nga OE janë sasi më të vogla nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë.

Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka interpretuar në mënyrë të gabuar ofertën e shoqërisë Krijon shpk.

Referuar deklaratës së ngarkuar në SPE edhe argumentimit më sipër lidhur me paketimet e artikujve objekt i kësaj procedure tenderimi, shoqëria Krijon shpk ka ofertuar duke marrë parasysh sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktues. Shoqëria Krijon shpk ka ngarkuar në SPE deklaratën me emërtim “ Deklarate Loti I ” ku shprehemi se marrim përsipër të furnizojmë të gjithë sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktues pavarësisht paketimit që ka prodhuesi

Kjo nënkupton që pavarësisht paketimi origjinal është me i vogël se paketimi minimal i kërkuar kompania jone do te furnizoje aq paketime sa janë te nevojshme për plotësimin e sasisë totale te kërkuar nga autoriteti.

Referuar artikullit nr. 83 i kërkuar ne shishe sasia jo më e vogël se 500 mg – 1 shishe, kompania jone edhe pse ka ofertuar me paketim 250 mg, për të respektuar sasinë totale të kërkuar e cila është 500 mg minimumi do të furnizojë 2 shishe nga paketimi origjinal i ofertuar.

Marrë parasysh se sasia dhe njësia e vendosur në dokumentet e tenderit nuk mund të ndryshohen nga operatori ekonomik, shoqëria jonë e ka lënë të pandryshuar sasinë e artikujve për të cilat ka ofruar paketim më të vogël sesa ai i përcaktuar nga AK. Në të njëjtën mënyrë do të argumentonim edhe për artikujt për të cilat paketimi është më i madh sesa ai i cituar në DST.

Në konkluzion të ankesës tonë,

- Kërkojmë kualifikimin e ofertës së Krijon shpk, pasi plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e kualifikimit të kërkuara në Dokumentet Standarte të Tenderit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3380/1 prot, datë 26.11.2025 me arsyet e skualifikimit të shoqërisë “Krijon” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.3380 prot.

II.6.2. Në datën 05.12.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3380/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 4105/1 prot., datë 05.12.2025 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “AlMedical” shpk, “Krijon” shpk dhe “Gamma” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: Loti 1 “Blerje standarte”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr. 144/2025, datë 04.12.2025. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë pranuar pjesërisht nga ky komision. Konkretisht KSHA ka argumentuar si më poshtë vijon:

“Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se “A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK [...] dhe C. Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikujt të ofruar zgn OE janë në sasi më të vogël nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë: (p.sh, për artikullin nr. 83 në DST kërkohet shishe 500 mg ndërkohë që OE, referuar ofertës teknike të paraqitur ka ofertuar shishe 250 mg dhe në shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” ka ofertuar sasinë 1 shishe. Në këto kushte nuk plotësohen specifikimet teknike pasi 250 mg ngelen jashtë ofertës).”, KSHA vëren se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 3 është përcaktuar se “3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit, procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO për këtë procedurë prokurimi, dokumentin “MAT_REFERENCE DHE STAND AL LOTI 1” të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues “Krijon” shpk konstaton se në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” dhe Shtojcën 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”, për Lotin 1 janë përcaktuar emërtimet e Standardeve, specifikimet teknike për secilin Standard të kërkuar, njësia dhe sasia e pritshme e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

KSHA konstaton se autoriteti kontraktor përfitues ka përcaktuar sasinë, për të cilën është planifikuar furnizimi me “Standard analitik” me paketimet përkatëse të llojit (shishe, pako,

ampulë, copë) në sasinë minimale 1 (një) dhe maksimale 4 (katër), duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me produktin e kërkuar, duke orientuar operatorët ekonomikë të interesuar për të përgatitur ofertat e tyre ekonomike. Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe se për përmbushjen e këtij synimi, ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve me anë të dorëzimit të mostra malli, fotografitë apo katalogët teknikë, dhe/ose dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar.

Referuar katalogëve të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ankimes, lidhur me sasinë e kërkuar në paketim për artikujt e kërkuar, rezulton se ka paraqitur:

Nr.13- Alfatoxine MI: është kërkuar ampule 3ml — është ofruar ampule 2ml ;

Nr.42-Buffer pH 9.21: është kërkuar shishe 500ml — është ofruar shishe 1000 ml ;

Nr.66 Dihydrosteptomycin sulphate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200gr — është ofruar 100 gr;

Nr.83-Isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg - është ofruar 250mg,
Nr.86 –Maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000mg — është ofruar në sasi 500mg,

Në kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr. 14 Aflatoxine totale (BI,B2,G1, G2), 10ml, Acetonitrile 1ml/ampul - ka ngarkuar produktin në përzierje përkatesisht (BI, B2, G1, G2, A)

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes të parashtruara në ankesën e tij, konstatohet se:

“1. Referuar arsyes së skualifikimit: OE nuk ka sjell katalog për produktin nr. 44 përkatesisht Nr.44 Buffer PH 7.0.

Arsyeja e skualifikimit paraqitur nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara nuk bazohet në fakte dhe prova. Shoqëria Krijon shpik pikërisht për këtë artikull ka paraqitur katalogun me emërtimin Katalog 31-60., konkretisht faqet të cilat janë deklaruar edhe në ofertën teknike [faqe 28,29,30,31].

Artikulli nr. 44 Buffer PH 7.0 është markuar me të verdhë me kodin 32096. 291, cili gjithashtu është i deklaruar në ofertën teknike.

Pavarësisht faktit që Autoriteti Kontraktues ka administruar katalogun dhe ofertën teknike, sjellim në vëmendje se referuar nenit 82 të VKM, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nëse është e nevojshme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilat duhet të jenë më shkrim dhe të pasqyruara në procesverbal.

2. Referuar arsyes së skualifikimit. Në kataloget e markuar në SPE nga operatori nuk janë të percaktuara paketimet me sasitë përkatese për artikujt nr. 1, 2, 5, 6, 9, 10, 11, 28, 30, 31, 36, 47, 49, 58, 69,71, 76,80,102,106,108,112,114,119,121,123,125,126,127,12, 8, 129, 130,131.

4. Referuar arsyes së skualifikimit:

Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar ampulë 3ml dhe është ofruar ampulë 2ml

nr. 42 . buffer ph 9.21, është kërkuar shishe 500 ml është ofruar shishe 1000 ml

nr. 66 dihydrosteotomycin sulphate, është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200 gr është ofruar 100 gr.

Nr.83 isoascorbic acid, është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg është ofruar 250mg

nr. 86 maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000 mg është ofruar në sasi 500 mg.

Nga sa më sipër, gjykojmë se Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka vendosur skualifikimin e ofertës tonë në kundërshtim me ligjin që rregullon prokurimet publike.

Së pari, skualifikimi nga një procedurë prokurimi me arsyetimin se nuk është markuar apo respektuar paketimi i artikujve është i pabazuar në ligj.

Së dyti, shoqëria Krijon shpk ka siguruar autoritetin kontraktues nëpërmjet deklaratës ngarkuar në SPE, se pavarësisht paketimit të kërkuar në DST për të gjithë artikujt, marrim përsipër që të furnizojmë të gjithë sasinë e kërkuar të artikujve objekt prokurimi. Deklarata përbën angazhim real dhe konkret të operatorit i cili merr përsipër furnizimin e artikujve sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjitha artikujt ku është kërkuar që paketimi të vijë origjinal dhe hermetik nga prodhuesi, do të furnizohen të pa hapura dhe në gjendjen fizike sipas kërkesës dhe kushteve të ruajtjes.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se do të furnizojë të gjithë sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktues pavarësisht paketimit që ka prodhuesi.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjithë artikujt e kërkuar do të jenë të shoqëruara me certifikatat e analizave nga prodhuesi.

Së treti, qëllimi themelor i autoritetit kontraktor është furnizimi me mallra cilësorë, me siguri dhe kualitet. Krijon shpk ka siguruar pikërisht këtë, mallrat do të dorëzohen pa kompromentuar cilësinë, dhe pa prishur paketimin për të shmangur rrezikun e dëmtimit, gjë që tregon fleksibilitet dhe kapacitet profesional për realizim me sukses të kontratës.

4. Referuar arsyes së skualifikimit : Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr. 14 aflatoxine totale (BI,B2,G1, G2), 10 mg/ml, Acetonitrile 1 ml/ampul OE ka ngarkuar produktin nga kompania Cayman Chemicals faqe 29,30,31, Catalog 1-30 ne të cilin produkti nuk ka 4 Component sic kerkohet ne DST por ka 5 Component ne perberjen perkatesisht (BI,B2,G I, G2,A) duke tejkualuar specifikimet teknike te kerkuara.

Referuar procesverbalit të argumentimit: Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose teresinë e elementeve me të rëndësishme përberese, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19. 05 2021, «Për miratimin e rregullave të prokurimit publik» (i ndryshuar).

Ne Shtojcën 9 “FORMULARI PERMBLEDHES I VETEDEKLARIMIT”, Pjesa III “Kriteret e Perzgjedhjes/Kualifikimit”, Pika A “DEKLARATE Ne përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës” ankimesi ka deklaruar se “Ne cilesine e operatorit ekonomik ne deklarojme se plotesojne te gjitha specifikimet teknike, sic udhezohet

ne dokumentet e tenderit, dhe kete e provojme permes certifikatave dhe dokumenteve te paraqitura me kete deklarate (nese kerkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim persiper te realizojme objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti kontraktor.”

Në Deklaratën e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik ankimues deklaroi se:

“Shoqeria Krijon shpk deklaroi se te gjitha artikujt ku eshte kerkuar qe paketimi te vije original dhe hermetik nga prodhuesi, do te furnizohen te pa hapura dhe ne gjendjen fizike sipas kerkeses dhe kushteve te ruajtjes.

Shoqeria Krijon shpk deklaroi se do te furnizojte te gjitha sasine e kerkuar nga autoriteti kontraktues pavaresisht paketimit qe ka prodhuesi.

Shoqeria Krijon shpk deklaroi se te gjitha artikujt e kerkuar do te jene te shoqeruara me certifikatat e analizave nga prodhuesi.”

KSHA gjykon se mënyra apo sasia e numrit të (shishe, pako, ampulë, copë) brenda kutisë së konfeksionit për të plotësuar sasinë e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk ndikon në interesin konkret të autoritetit kontraktor pëfitues pasi, për këtë të fundit është e rëndësishme që të sigurohet një furnizim me “Standarde analitike” të kërkuara sipas listës së sipërcituar, duke plotësuar sasinë përkatëse, në njërin nga format (shishe, pako, ampulë, copë) e kërkuara si dhe në sasinë totale të kërkuar. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se interesi i autoritetit kontraktor është realizimi me sukses i kontratës dhe nuk ka sesi ky interes të çenohet nga numri apo forma e konfeksionit të një Standardi të ofertuar, për aq kohë që ky produkt plotëson specifikimet teknike të përcaktuara. Referuar ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit me dokumentacionin e paraqitur krijon bindjen se plotëson kërkesat dhe specifikimet e Standardeve Analitike të kërkuara, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Dokumentet e Tenderit.

Për sa më sipër, **pretendimet e operatorit ekonomik ankimues** lidhur me sasinë apo mënyrën e paketimit të produktit **qëndrojnë**.

Referuar arsyes se skualifikimit se “OE nuk ka sjell katalog per produktiv nr. 44 perkatesisht Nr. 44- Buffer PH 7.C”, nga verifikimi i kryer nga KSHA rezulton se ankimuesi per kete artikull ka paraqitur katalogun me emërtimin “Katalog 31-60”, ku konkretisht në faqet 28,29,30,31 është deklaruar Artikulli nr. 44 “Buffer PH 7.0”, i markuar me të verdhë, i cili përmban kodin 32096.291, duke përmbushur specifikimet e kërkuara në DT.

Lidhur me artikullin nr. 14 aflatoxine totale (B1,B2,G1,G2), 10 pg/ml, Acetonitrile 1 ml/ampul, OE ka ngarkuar produktin nga kompania Cayman Chemicals faqe 29,30,31, katalog 1-30 në të cilin produkti përmban 5 komponentë në përbërjen totale, përkatësisht (B1,B2,G1,G2,A), pra 1 komponent më tepër se aflatoxine totale (B1,B2,G1,G2) me 4 komponentë siç kërkohej në DT. Rrjedhimisht, aflatoxine totale (B1,B2,G1, G2, A) e ofertuar nga operatori ekonomik ankimues është në kushtet e përmbushjes dhe tejkallimit të specifikimeve teknike të kërkuara pasi, testi me 5 komponentë mbulon gjithçka që mbulon ai me 4 komponentë por me një analizë më të zgjeruar.

Për sa më sipër, **pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë**.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se “B. OE nuk plotëson Pikën 2.3.5 të KVK[...], OE nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi TRC (Toronto Research Chemicals) për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim”, KSHA vëren se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 5 është përcaktuar se “5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr.rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 47, 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te veçantë.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik ankimues në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Toronto Research Chemicals (TRC) ku përcaktohet:

- Numri i katalogut C521000;

- Emri i produktit Citric Acid;

- Autorizim Prodhuesi nga Kompania prodhuese LGC me listën e produkteve të autorizuara:

- TRC-A6I 1092-IOMG*
- TRC-C521000-1G*
- DRE-C16493000*
- DRE-VI0047 100AL-2*
- DRE-V I0047550AL-0.5*
- DRE-C10125000*
- DRE-C 13175500*
- INBIO-NA-STM-1*

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të parashtruara në ankesën e tij, konstatohet

se: “Së pari, TRC (Toronto Research Chemicals) është pjesë e kompanisë LGC. Së dyti, në autorizimin e dorëzuar në SPE nga kompania LGC janë të cituar të gjithë artikujt për të cilat shoqëria Krijon shpk autorizohet të tregëtojë dhe të paraqesë ofertë, ndër këto është edhe artikulli nr. 9 Acid Citrik me kod C521000- IG. Kodi i cituar është edhe tek oferta teknike. Do të ishte e pamundur që një kompani prodhuese (LGC) të specifikonte në një autorizim të dhënë produkte të cilat nuk do i furnizonte ajo vetë. Nëse Operatori i Blerjeve të Përqendruara do të kishte paqartësi lidhur me autorizimin e prodhuesit, në këtë rast të LGC ku duken qartë artikujt, kodet për të cilat autorizon, mund të kishte kontaktuar në adresat e shënuara në autorizim.

Në një kërkim të thjeshtë në faqen e web-it të kompanisë LGC informohesh se TRC dhe disa kompani të tjera janë pjesë e LGC. Bashkëngjitur dokumentacionin për verifikimin e faktit marrë në faqet e web-it të kompanive TRC dhe LGC.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet

të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomikë, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorit Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KSHA gjykon, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorit ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Pra, është përgjegjësi e Operatorit Ekonomik të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kritereve të përcaktuara në DT, si dhe referuar edhe parimit të onus probandi incumbit ei qui dicit (barrën e provës e mban ai që pretendon), të faktojë e sqarojë lidhjen e cdo dokumenti të dorëzuar me plotësimin e kriterit përkatës. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues në fazën e ofertimit nuk ka arritur të faktojë se ka paraqitur një autorizim prodhuesi për kompaninë prodhuese nga e cila ka paraqitur katalogun përkatës lidhur me artikullin nr. 9: Acid Citrik, e rrjedhimisht vlerësimi i KVO-së është i saktë. Kriteri i sipërcituar në pikën 2.3.5 përcakton qartë paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin katalogje/skedë teknike të prodhuesit për të gjithë artikujt e ofruar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues “Krijon” shpk ka pasur paqartësi lidhur me plotësimin e kritereve dhe dorëzimin e dokumentacionit kualifikues por gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “I. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor i cili duhet t'i përgjigjet cdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga cdo operator ekonomik me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]”.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK, për skualifikimin e tij të padrejtë në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar Vendimit të KSHA-së nr.144/2025, me nr.4105 prot., datë 04.12.2025 rezulton se pretendimet e ankimuesit janë pranuar plotësisht nga ky komision.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Gamma” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar Vendimit të KSHA-së nr.144/2025, me nr.4105 prot., datë 04.12.2025 rezulton se pretendimet e ankimuesit për skualifikimin e tij të padrejtë nga KVO-ja, janë pranuar plotësisht nga ky komision.

III.2.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.2.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK, për skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e KVO-së, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Referuar Vendimit të KSHA-së nr.144/2025, me nr.4105 prot., datë 04.12.2025 rezulton se KSHA ka vendosur pranim të pjesshëm të ankesës lidhur me pretendimet e ankimuesit për skualifikimin e tij të padrejtë nga KVO-ja. Konkretisht janë pranuar pretendimet e ankimuesit si më poshtë vijon:

“Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se “A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK [...] dhe C. Oferta e paraqitur nga OE në prokurim është për sasi të artikujve të përcaktuar në DST, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Duke qenë se disa artikujt të ofruar zgn OE janë në sasi më të vogël nga ajo e kërkuar rezulton se oferta ekonomike nuk është e saktë: (p.sh, për artikullin nr. 83 në DST kërkohet shishe 500 mg ndërkohë që OE, referuar ofertës teknike të paraqitur ka ofertuar shishe 250 mg dhe në shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” ka ofertuar sasinë 1 shishe. Në këto kushte nuk plotësohen specifikimet teknike pasi 250 mg ngelen jashtë ofertës).”, KSHA vëren se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 3 është përcaktuar se “3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara

sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit, procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO për këtë procedurë prokurimi, dokumentin “MAT_REFERENCE DHE STAND AL LOTI 1” të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimes “Krijon” shpk konstaton se në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” dhe Shtojcën 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”, për Lotin 1 janë përcaktuar emërtimet e Standardeve, specifikimet teknike për secilin Standard të kërkuar, njësia dhe sasia e pritshme e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

KSHA konstaton se autoriteti kontraktor përfitues ka përcaktuar sasinë, për të cilën është planifikuar furnizimi me “Standard analitik” me paketimet përkatëse të llojit (shishe, pako, ampulë, copë) në sasinë minimale 1 (një) dhe maksimale 4 (katër), duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me produktin e kërkuar, duke orientuar operatorët ekonomikë të interesuar për të përgatitur ofertat e tyre ekonomike. Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofruese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe se për përmbushjen e këtij synimi, ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve me anë të dorëzimit të mostra malli, fotografitë apo katalogët teknikë, dhe/ose dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar.

Referuar katalogëve të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ankimes, lidhur me sasinë e kërkuar në paketim për artikujt e kërkuar, rezulton se ka paraqitur:

Nr.13- Alfatoxine MI: është kërkuar ampule 3ml — është ofruar ampule 2ml ;

Nr.42-Buffer pH 9.21: është kërkuar shishe 500ml — është ofruar shishe 1000 ml ;

Nr.66 Dihydrosteptomycin sulphate: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200gr — është ofruar 100 gr;

Nr.83-Isoascorbic acid: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg - është ofruar 250mg,

Nr.86 –Maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000mg — është ofruar në sasi 500mg,

Në kataloget e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr. 14 Aflatoxine totale (BI, B2, G1, G2), 10ml, Acetonitrile 1ml/ampul - ka ngarkuar produktin në përzierje përkatësisht (BI, B2, G1, G2, A)

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes të parashtruara në ankesën e tij, konstatohet se:

“I. Referuar arsyes së skualifikimit: OE nuk ka sjell katalog për produktin nr. 44 përkatësisht Nr.44 Buffer PH 7.0.

Arsyeja e skualifikimit paraqitur nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara nuk bazohet në fakte dhe prova. Shoqëria Krijon shpk pikërisht për këtë artikull ka paraqitur katalogun me

emërtimin Katalog 31-60., konkretisht faqet të cilat janë deklaruar edhe në ofertën teknike [faqe 28,29,30,31).

Artikulli nr. 44 Buffer PH 7.0 është markuar me të verdhë me kodin 32096. 291, cili gjithashtu është i deklaruar në ofertën teknike.

Pavarësisht faktit që Autoriteti Kontraktues ka administruar katalogun dhe ofertën teknike, sjellim në vëmendje se referuar nenit 82 të VKM, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nëse është e nevojshme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilat duhet të jenë më shkrim dhe të pasqyruara në procesverbal.

2. Referuar arsyes së skualifikimit. Në kataloget e markuar në SPE nga operatori nuk janë të percaktuara paketimet me sasitë perkatese për artikujt nr. 1, 2, 5, 6, 9, 10, 11, 28, 30, 31, 36, 47, 49, 58, 69,71, 76,80,102,106,108,112,114,119,121,123,125,126,127,12, 8, 129, 130,131.

4. Referuar arsyes së skualifikimit:

Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori nuk përputhen sasia e kërkuar ampulë 3ml dhe është ofruar ampulë 2ml

nr. 42 . buffer ph 9.21, është kërkuar shishe 500 ml është ofruar shishe 1000 ml

nr. 66 dihydrosteotomycin sulphate, është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 200 gr është ofruar 100 gr.

Nr.83 isoascorbic acid, është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 500 mg është ofruar 250mg

nr. 86 maltitol: është kërkuar shishe sasi jo më e vogël se 1000 mg është ofruar në sasi 500 mg.

Nga sa më sipër, gjykojmë se Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka vendosur skualifikimin e ofertës tonë në kundërshtim me ligjin që rregullon prokurimet publike.

Së pari, skualifikimi nga një procedurë prokurimi me arsyetimin se nuk është markuar apo respektuar paketimi i artikujve është i pabazuar në ligj.

Së dyti, shoqëria Krijon shpk ka siguruar autoritetin kontraktues nëpërmjet deklaratës ngarkuar në SPE, se pavarësisht paketimit të kërkuar në DST për të gjithë artikujt, marrim përsipër që të furnizojmë të gjithë sasinë e kërkuar të artikujve objekt prokurimi. Deklarata përbën angazhim real dhe konkret të operatorit i cili merr përsipër furnizimin e artikujve sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjitha artikujt ku është kërkuar që paketimi të vijë origjinal dhe hermetik nga prodhuesi, do të furnizohen të pa hapura dhe në gjendjen fizike sipas kërkesës dhe kushteve të ruajtjes.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se do të furnizojë të gjithë sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktues pavarësisht paketimit që ka prodhuesi.

Shoqëria Krijon shpk deklaron se të gjithë artikujt e kërkuar do të jenë të shoqëruara me certifikatat e analizave nga prodhuesi.

Së treti, qëllimi themelor i autoritetit kontraktor është furnizimi me mallra cilësorë, me siguri dhe kualitet. Krijon shpk ka siguruar pikërisht këtë, mallrat do të dorëzohen pa kompromentuar cilësinë, dhe pa prishur paketimin për të shmangur rrezikun e dëmtimit, gjë që tregon fleksibilitet dhe kapacitet profesional për realizim me sukses të kontratës.

4. Referuar arsyes së skualifikimit : Në katalogët e ngarkuar në SPE nga operatori për artikullin nr. 14 aflatoxine totale (BI,B2,GI, G2), 10 mg/ml, Acetonitrile 1 ml/ampul OE ka ngarkuar produktin nga kompania Cayman Chemicals faqe 29,30,31, Catalog 1-30 në të cilin

produkti nuk ka 4 Component sic kerkohet ne DST por ka 5 Component ne perberjen perkatesisht (BI,B2,G I, G2,A) duke tejkualuar specifikimet teknike te kerkuara.

Referuar procesverbalit te argumentimit: Specifikimet teknike, per mallin objekt prokurimi, pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, dhe qe e vlereson mallin si te pranueshem per funksionet e kerkuara si dhe eshte ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 40, pika 2, te VKM nr. 285, date 19. 05 2021, «Per miratimin e rregullave te prokurimit publik» (i ndryshuar).

Ne Shtojcen 9 “FORMULARI PERMBLEDHES I VETEDEKLARIMIT”, Pjesa III “Kriteret e Perzgjedhjes/Kualifikimit”, Pika A “DEKLARATE Ne perputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit te objektit te kontrates” ankimuesi ka deklaruar se “Ne cilesine e operatorit ekonomik ne deklarojme se plotesojne te gjitha specifikimet teknike, sic udhezohet ne dokumentet e tenderit, dhe kete e provojme permes certifikatave dhe dokumenteve te paraqitura me kete deklarate (nese kerkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim persiper te realizojme objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti kontraktor.”

Në Deklaratën e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik ankimues deklaroi se:

“Shoqeria Krijon shpk deklaroi se te gjitha artikujt ku eshte kerkuar qe paketimi te vije original dhe hermetik nga prodhuesi, do te furnizohen te pa hapura dhe ne gjendjen fizike sipas kerkeses dhe kushteve te ruajtjes.

Shoqeria Krijon shpk deklaroi se do te furnizojte te gjitha sasine e kerkuar nga autoriteti kontraktues pavaresisht paketimit qe ka prodhuesi.

Shoqeria Krijon shpk deklaroi se te gjitha artikujt e kerkuar do te jene te shoqeruara me certifikatat e analizave nga prodhuesi.”

KSHA gjykon se menyra apo sasia e numrit të (shishe, pako, ampulë, copë) brenda kutisë së konfeksionit për të plotësuar sasinë e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk ndikon në interesin konkret të autoritetit kontraktor pëfitues pasi, për këtë të fundit është e rëndësishme që të sigurohet një furnizim me “Standarde analitike” të kërkuara sipas listës së sipërcituar, duke plotësuar sasinë përkatëse, në njërën nga format (shishe, pako, ampulë, copë) e kërkuara si dhe në sasinë totale të kërkuar. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se interesi i autoritetit kontraktor është realizimi me sukses i kontratës dhe nuk ka sesi ky interes të çenohet nga numri apo forma e konfeksionit të një Standardi të ofertuar, për aq kohë që ky produkt plotëson specifikimet teknike të përcaktuara. Referuar ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit me dokumentacionin e paraqitur krijon bindjen se plotëson kërkesat dhe specifikimet e Standardeve Analitike të kërkuara, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Dokumentet e Tenderit.

Për sa më sipër, **pretendimet e operatorit ekonomik ankimues** lidhur me sasinë apo mënyrën e paketimit të produktit **qëndrojnë**.

Referuar arsyes se skualifikimit se “OE nuk ka sjell katalog per produktiv nr. 44 perkatesisht Nr. 44- Buffer PH 7.C”, nga verifikimi i kryer nga KSHA rezulton se ankimuesi per kete artikull ka paraqitur katalogun me emërtimin “Katalog 31-60”, ku konkretisht në faqet 28,29,30,31

është deklaruar Artikulli nr. 44 “Buffer PH 7.0”, i markuar me të verdhë, i cili përmban kodin 32096.291, duke përmbushur specifikimet e kërkuara në DT.

Lidhur me artikullin nr. 14 aflatoxine totale (B1,B2,G1,G2), 10 pg/ml, Acetonitrile 1 ml/ampul, OE ka ngarkuar produktin nga kompania Cayman Chemicals faqe 29,30,31, katalog 1-30 në të cilin produkti përmban 5 komponentë në përbërjen totale, përkatësisht (B1,B2,G1,G2,A), pra 1 komponent më tepër se aflatoxine totale (B1,B2,G1,G2) me 4 komponentë siç kërkohet në DT. Rrjedhimisht, aflatoxine totale (B1,B2,G1, G2, A) e ofertuar nga operatori ekonomik ankimes është në kushtet e përmbushjes dhe tejkalimit të specifikimeve teknike të kërkuara pasi, testi me 5 komponentë mbulon gjithçka që mbulon ai me 4 komponentë por me një analizë më të zgjeruar.

Për sa më sipër, **pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.**

III.3.2. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, përse kohë që operatorët e tjerë ekonomikë nuk kanë paraqitur argumenta dhe nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor mbi trajtimin e ankesës së ankimesit.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës, pretendimet e të cilës nuk janë pranuar nga KSHA.

III.3.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Krijon” SHPK se: “OE nuk plotëson Pikën 2.3.5 të KVK e cila përcakton: “5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga Distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr. rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 47, 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te veçantë.

OE nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi TRC (Toronto Research Chemicals) për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3, 5 dhe 6 e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar, si më poshtë vijon:

3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit

me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, për artikujt me nr.rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 47, 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi të veçantë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt objekt prokurimi në formë tabele, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit.

III.3.3.2. Në shtojcën 7, “Formulari i specifikimeve teknike”, për artikullin nr.9 është parashikuar:

STANDARDE ISUV I 2025 LOTI I				
Nr.	EMERTIMI	SPECIFIKIMET TEKNIKE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
9	Acid citrik	Standart analitik CAS 77-92-9, Pastërtia $\geq 99\%$ pluhur i imët, Shishe sasia jo më e vogël se 100 mg, e shoqëruar me certifikate analitike	shishe	1

III.3.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.3.5. Në nenin 40 pika 1, 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPPsë, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

III.3.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të

refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.3.7. Lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit përse i përket artikullit 9, shoqëria “Krijon” SHPK pretendon se:

“Referuar arsyes së skualifikimit OE nuk plotëson pikën 2.3.5 të KVK e cila përcakton: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, për artikujt me nr. rendor 4,5,6,9,10,12,13,14,27,31,33,37,39,47,67,70,78 dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi të vecantë. OE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi TRC për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim.

Së pari, TRC (Tornoto Research Chemicals) është pjesë e kompanisë LGC.

Së dyti, në autorizimin e dorëzuar në SPE nga kompania LGC janë të cituar të gjithë artikujt për të cilat shoqëria Krijon shpk autorizohet të tregëtojë dhe të paraqesë ofertë, ndër këto është edhe artikulli nr. 9 Acid Citrik me kod C521000-1G. Kodi i cituar është edhe tek oferta teknike. Do të ishte e pamundur që një kompani prodhuese (LGC) të specifikonte në një autorizim të dhënë produkte të cilat nuk do i furnizonte ajo vetë.

Nëse Operatori i Blerjeve të Përqendruara do të kishte paqartësi lidhur me autorizimin e prodhuesit, në këtë rast të LGC ku duken qartë artikujt – kodet për të cilat autorizon, mund të kishte kontaktuar në adresat e shënuara në autorizim.

Në një kërkim të thjeshtë në faqen e web-it të kompanisë LGC informohesh se TRC dhe disa kompani të tjera janë pjesë e LGC. Bashkëngjitur dokumentacionin për verifikimin e faktit marrë në faqet e web-it të kompanive TRC dhe LGC.
[...]”.

III.3.3.8. Në përgjigjen e dhënë ankesës së paraqitur, autoriteti kontraktor argumenton si vijon: *“Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk mbi kundërshtimin e*

vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se “B. OE nuk plotëson Pikën 2.3.5 të KVK[...], OE nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi TRC (Toronto Research Chemicals) për artikullin nr. 9 Acid Citrik të kërkuar në pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim”, KSHA vëren se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 5 është përcaktuar se “5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr.rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 47, 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te veçantë.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik ankimues në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Toronto Research Chemicals (TRC) ku përcaktohet:
- Numri i katalogut C521000;
- Emri i produktit Citric Acid;
- Autorizim Prodhuesi nga Kompania prodhuese LGC me listën e produkteve të autorizuara:
 - TRC-A6I 1092-IOMG
 - TRC-C521000-1G
 - DRE-C16493000
 - DRE-VI0047 I00AL-2
 - DRE-V I0047550AL-0.5
 - DRE-C10125000
 - DRE-C 13175500
 - INBIO-NA-STM-1

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të parashtruara në ankesën e tij, konstatohet se:

“Së pari, TRC (Toronto Research Chemicals) është pjesë e kompanisë LGC.

Së dyti, në autorizimin e dorëzuar në SPE nga kompania LGC janë të cituar të gjithë artikujt për të cilat shoqëria Krijon shpk autorizohet të tregëtojë dhe të paraqesë ofertë, ndër këto është edhe artikulli nr. 9 Acid Citrik me kod C521000- IG. Kodi i cituar është edhe tek oferta teknike. Do të ishte e pamundur që një kompani prodhuese (LGC) të specifikonte në një autorizim të dhënë produkte të cilat nuk do i furnizonte ajo vetë. Nëse Operatori i Blerjeve të Përqendruara do të kishte paqartësi lidhur me autorizimin e prodhuesit, në këtë rast të LGC ku duken qartë artikujt, kodet për të cilat autorizon, mund të kishte kontaktuar në adresat e shënuara në autorizim.

Në një kërkim të thjeshtë në faqen e web-it të kompanisë LGC informohesh se TRC dhe disa kompani të tjera janë pjesë e LGC. Bashkëngjitur dokumentacionin për verifikimin e faktit marrë në faqet e web-it të kompanive TRC dhe LGC.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet

të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomikë, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorit Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KSHA gjykon, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorit ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Pra, është përgjegjësi e Operatorit Ekonomik të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kritereve të përcaktuara në DT, si dhe referuar edhe parimit të onus probandi incumbit ei qui dicit (barrën e provës e mban ai që pretendon), të faktojë e sqarojë lidhjen e cdo dokumenti të dorëzuar me plotësimin e kriterit përkatës. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues në fazën e ofertimit nuk ka arritur të faktojë se ka paraqitur një autorizim prodhuesi për kompaninë prodhuese nga e cila ka paraqitur katalogun përkatës lidhur me artikullin nr. 9: Acid Citrik, e rrjedhimisht vlerësimi i KVO-së është i saktë. Kriteri i sipërcituar në pikën 2.3.5 përcakton qartë paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin katalogje/skedë teknike të prodhuesit për të gjithë artikujt e ofruar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues “Krijon” shpk ka pasur paqartësi lidhur me plotësimin e kritereve dhe dorëzimin e dokumentacionit kualifikues por gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “I. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor i cili duhet t'i përgjigjet cdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga cdo operator ekonomik me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qendrojnë”.

III.3.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën e paraqitur në SPE nga shoqëria ankimuese “Krijon” SHPK, ku rezulton se për artikullin me nr.rendor 9, është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Katalog 1-30

- Oferta teknike

- Autorizim Prodhuesi nga Kompania prodhuese LGC me listën e produkteve të autorizuar:

- TRC-A6I 1092-IOMG
- TRC-C521000-1G
- DRE-C16493000
- DRE-VI0047 100AL-2
- DRE-V I0047550AL-0.5
- DRE-C10125000
- DRE-C 13175500
- INBIO-NA-STM-1

III.3.3.10 Lidhur me artikullin nr.9, në tabelën “Oferta teknike” nga ana e ankimuesit është deklaruar si vijon:

KRIJON

Rruga e Elbasanit Nr. 57
Çollak, 1004 Tirana, ALBANIA

VAT No. K12023001A
Tel. +355 42 340817
e-mail: sales@krijon.al

Oferta Teknike

Per : Operatori i Blerjeve te Pergendruara

Nr	Emri i kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit	Nr. e faqes ku ndodhet produkti	Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit.
9	TRC	Katalog 1-30	17	C521000

Pra është deklaruar emri i kompanisë prodhuese “TCR”, emërtimi i katalogut në SPE, numri i faqes 17 në katalog ku ndodhet produkti me treguesit teknike si dhe numri i referencës së artikullit (kodi) sipas katalogut të prodhuesit, që në rastin konkret është C521000.

Gjithashtu është paraqitur autorizim prodhuesi nga LGC Standards GmbH, me anë të së cilës konfirmohet se shoqëria “Krijon” SHPK ka të drejtën e rishitjes (jo ekskluzive), të produkteve të prodhuara nga LGC Standards GmbH, të paraqesë një ofertë dhe më pas të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë me ISUV-in per proceduren me nr.ref- 63098-09-30-2025. Në listën e produkteve të autorizuar nga kompania LGC Standards GmbH është edhe produkti TRC-C521000-1G. Sipas katalogut 1-30 të ngarkuar në SPE nga shoqëria “Krijon” SHPK, rezulton se produkti “Citric Acid” me nr: C521000 i përket kompanisë Toronto Research Chemicals (TRC) dhe në fund të faqes janë të dhënat e si vijon:

101 Milani Blvd., Vaughan, ON., L4H 4M4 Canada Tel: (416) 665-9696 E-mail: Orders.TRC@LGCGroup.com Website: www.lgcstandards.com
--

Në kushtet kur operatori ekonomik ankimues ka dhënë një indicie për autoritetin kontraktor, pasi në fund të faqes së katalogut është dhënë adresa e email-it Orders.TRC@LGCGroup.com, ky i fundit, referuar nenin 92 te LPP ka patur detyrimin procedural që, për këtë artikull, të

kryejë verifikimet përkatëse apo të kërkojë sqarime nga ankimuesi, gje për të cilin rezulton se AK nuk i ka kryer këto verifikime, duke e marrë të mirëqenë që shoqëria “Krijon” SHPK, nuk plotëson kapacitetin në lidhje me artikullin nr.9.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Gamma” SHPK për shoqërinë “Krijon” SHPK se: *“përveç arsyeve të permendura nga Autoriteti Kontraktor, është e nevojshme të theksohet se kompania “Krijon” sh.p.k, mund të ketë ofruar produkte në artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112, të cilat nuk janë standarde analitike sipas kërkesave të përcaktuara në DST, por reagente të zakonshëm laboratorike. Është e rëndësishme të nënvizohet se dallimi ndërmjet një reagenti dhe një standardi analitik është thelbësor në aspektin shkencor dhe teknik: ? Reagenti përdoret për kryerjen e reaksioneve kimike ose përgatitjen e mostrave; ? Ndërsa standardi analitik është një substancë e testuar dhe e certifikuar, që shërben për kontrollin e saktësisë dhe precizionit të analizave laboratorike. Për këtë arsye, cmimi dhe çësia e një standardi analitik janë dukshëm më të larta krahasuar me një reagent të thjeshtë, dhe zëvendësimi i njerit me tjetrin përben devijim nga specifikimet teknike të parashikuara në DST. Gjithashtu, për produktet me numër rendor 12, 13, 14 dhe 47, operatori në fjalë mund të mos ketë paraqitur Autorizimin e Prodhuesit, dokument i cili është obligim ligjor sipas nenit 45 të VKM nr. 914, datë 29.12.2020, “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik” dhe pikën 5 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit - Kapaciteti Teknik, që kërkon që ofertuesi të provojë marrëdhënien zyrtare me prodhuesin në rastet e produkteve specifike laboratorike. Për rrjedhojë, duke u bazuar në faktet dhe argumentet e mësipërme, si dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe të VKM nr. 914/2020, operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k duhet të qëndrojë i skualifikuar, pasi mendojmë që oferta e tij nuk përmbush kërkesat ligjore dhe teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe është në kundërshtim me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme”, referuar Vendimit të KSHA-së nr. 144/2025, datë 04.12.2025 rezulton se pretendimet e ankimuesit për shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Krijon” SHPK janë pranuar pjesërisht nga KSHA-ja, duke argumentuar si më poshtë vijon: “Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Gamma” shpk mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e dorëzuar nga shoqëria “Krijon” shpk duke pretenduar se “[...] kompania “Krijon” sh p k. mund të ketë ofruar produkte në artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112, të cilat nuk janë standarde analitike sipas kërkesave të përcaktuara në DST, por reagentë të zakonshëm laboratorikë. [...] Gjithashtu, për produktet me numër rendor 12, 13, 14 dhe 47, operatori në fjalë mund të mos ketë paraqitur Autorizimin e Prodhuesit, dokumenti i cili është obligim ligjor sipas nenit 45 të VKM nr. 914, datë 29.12.2020, Për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe pikën 5 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, që kërkon që ofertuesi të provojë marrëdhënien zyrtare me prodhuesin në rastet e produkteve specifike laboratorike.”, KSHA vëren se:*

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 3 është përcaktuar se “3.Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertën. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemin elektronik të prokurimit.”

2	1,7 diaminoheptane	Standard i brendshëm; C ₇ H ₁₈ N ₂ , shishe 25g, me pastërti ≥98%, shoqëruar me certifikate analitike	shishe	1
75	Glyceryl 1,3-distearate	Standart analitik CAS 504-40-5, pastërti ≥99.0%, shishe sasia jo më e vogël se 100mg, e shoqëruar me certifikate analitike	shishe	2
111	Ponceau 4R	Standart analitik CAS 2611-82-7, pastërti për ≥98% , shishe sasia jo më e vogël se 25 mg, e shoqëruar me certifikate analitike	shishe	2
112	Potassium nitrate	Standart analitik Me pastërti, 99.0% shishe me paketim sasia jo më e vogël se 100 mg, e shoqëruar me certifikate analitike	shishe	1

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik “Krijon” shpik në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Thermo Fisher Scientific (katalog 1-30; faqe 2) ku përcaktohet:

- Emërtimi i dokumentit: “Certificate of Analysis” — Certifikatë Analize/Raport Analizë;
- Catalogue number: 11220
- Description: 1,7 diaminoheptane, 98%
- CAS Number: 646-19-5

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Sigma-Aldrich (katalog 61 -9 l; faqe 41) ku përcaktohet:

- Emërtimi i dokumentit “Product Specification” — Specifikimet e Produktit;
- Product Name: Glyceryl 1,3-distearate ≥ 99.0%
- Product number: D8269
- CAS Number: 504-40-5

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese DR. Ehrenstorfer (katalog 92-115; faqe 30-31-32) ku përcaktohet:

- Emërtimi i dokumentit: “Certificate of Analysis” — Certifikatë Analize/Raport Analizë
- Product Name: Ponceau 4RC (E124)
- Product Code: DRE-C16284000
- CAS Number: 2611-82-7

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese DR. Ehrenstorfer (katalog 92-115; faqe 33) ku përcaktohet:

- Emërtimi i dokumentit: “Certificate” — Të dhëna teknike/kimike
- Product Name: Potassium Nitrate
- USP Catalog No.: 1548349
- USP Lot No.: R 153G0

- CAS Number: 7757-79-1

[...]Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPA nga operatori ekonomik “Krijon” shpk, KSHA vëren se ky i fundit, lidhur me përmbushjen e kriterit 2.3.3 të sipërcituar, për artikujt nr. 2, 79, 111 dhe 112 ka paraqitur fletë nga katalogët e prodhuesve përkatës me emërtimin “Certificate of Analysis” - Certifikatë Analize, e cila në vetvete rezulton të jetë një Raport Analizë për artikujt përkatës. Nga ana tjetër KSHA vëren se në specifikimet teknike të përcaktuara në DT, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që këto produkte “Standarde Analitike” të shoqërohen edhe me Certifikatë Analitike ose (CRM) Certified Reference Material. Duke i'u referuar objektit të prokurimit “Loti 1. “Blerje standarte”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)”, KSHA konstaton se nga ana e operatorit ekonomik “Krijon” shpk nuk është dorëzuar dokumentacioni i plotë sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në specifikimet teknike të DT pasi, ai nuk ka shoqëruar produktet e sipërcituara me një Certified Reference Material, por thjesht me një Raport Analizë, e rrjedhimisht duke mos plotësuar kriterin e sipërcituar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

Për sa me sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Gamma” shpk lidhur me ofertën e shoqërisë “Krijon” shpk **qëndrojnë**.

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nënpika 5 është përcaktuar se “5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejin e tregëtimit të artikujve të tij, per artikujt me nr. rendor 4, 5, 6, 9, 10, 12, 13, 14, 27, 31, 33, 37, 39, 4 , 67, 70, 78, dhe 131, pasi konsiderohen mallra me rëndësi te vecantë.”

12	Aflatoxine B1	Standart analitik solucion , me përqendrim 10 {ig/mL ne acetonitrile, paketim shishe/ampule, sasia totale 5 ml,	shishe	1
13	Afiatoxine M1.	Solucion standart me perqendrim 1 pg/ml (.I tretur ne acetonitril), paketim origjinal (ampule) e shoqeruar me certifikate analitike.sasia totale 3ml	shishe	1
14	Aflatoxine Totale .	Aflatoxins (B1, B2, G1, G2) , 10 pg/mL, Acetonitrile, 1 mL/ampul.	shishe	2
47	CRM AZA 3	Material Reference i Certifikuar AZA 3 eshte nje solucion kalibrues per percaktimin e Azaspiracid-3 (AZA3) nepermjet metodave kimike analitike. I tretur ne metanol, me perqendrim jo me pak se 1.32ug/g. Cdo ampule ka 0.5 mL, shoqeruar me certifikate analitike. Nga NRC Kanada ose ekuivalent.	ampule	6

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik “Krijon” shpk në SPE, konstatohet se lidhur me plotësimin e kriterit të sipërcituar, ankimuesi ka dorëzuar:

- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese Trilogy (katalog 1-30) ku përcaktohet:
- Aflatoxine B 1, me përqendrim 10 pg/ml në acetonitrile, sasia totale 5 ml, (faqe 24-25);

- Aflatoxine MI, me përqendrim 1 pg/ml në acetonitrile, sasia totale 3ml (faqe 26-27);
- Autorizim Prodhuesi nga Kompania prodhuese Trilogy Analytical Laboratory me listën e produkteve që prodhon kjo kompani:
 - Naturally Contaminated Reference Material
 - Reference Standards in liquid form, (Aflatoxin in Acetonitrile)
 - Reference Standards in dried form
 - Solid Phase Extraction Purification Columns (QP1000 & QP 1100)
- Fletë katalogu nga Kompania prodhuese NRC-CNRC (katalog 31-60) ku përcaktohet:
- Material Reference i Certifikuar Azaspiracid-3 (AZA3), i tretur në metanol, me përqendrim 1.51 pg /g.
- Dokument/shkresë reference nga Kompania prodhuese National Research Council Canada (NRC) për shoqërinë Krijon shpk.

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik "Krijon" shpk, KSHA konstaton se, lidhur me produktet Aflatoxine B1 dhe Aflatoxine M1 është paraqitur Autorizimi i Prodhuesit "Trilogy Analytical Laboratory", i cili përmban të gjithë elementët përkatës në përputhje me kriterin 2.3.5 të sipërcituar.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues "Gamma" shpk lidhur me ofertën e shoqërisë "Krijon" shpk **nuk qendron**.

Sa i takon produktit nr. 47 "Azaspiracid-3 (AZA3)" shoqëria "Krijon" shpk ka paraqitur Fletë katalogu nga Kompania prodhuese NRC-CNRC si dhe një dokument letër reference, ku kompania prodhuese NRC vlerëson pozitivisht bashkëpunimin me këtë shoqëri, por pa dhënë asnjë element autorizues lidhur me produktet që ajo prodhon e për më tepër lidhur me artikullin nr. 47 Material Reference i Certifikuar Azaspiracid-3 (AZA3), i tretur në metanol, me përqendrim 1.51 pg /g. Rrjedhimisht ky dokument nuk mund të konsiderohet një Autorizim Prodhuesi, duke mos plotësuar kriterin e sipërcituar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues "Gamma" shpk lidhur me ofertën e shoqërisë "Krijon" shpk **qëndron**.

III.4.1. Neni 30, pika 1 e LPP-së të ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik."

III.4.2. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.4.3. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se janë paraqitur argumente nga “Krijon” SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar në datën 02.12.2025, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, por nuk është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik i interesuar “Krijon” SHPK, pavarësisht vënies në dijen në datë 05.12.2025 nga autoriteti kontraktor për vendimin e marrë prej tij.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3378/2025 datë 25.11.2025, të operatorit ekonomik “Gamma” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Gamma” SHPK nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK.
 5. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim si dhe referuar vendimit të KSHA-së nr.144/2025 sa i përket pretendimeve të shoqërisë “Gamma” SHPK për ofertën e shoqërisë “Krijon” SHPK.
 6. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA -së, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK.
 8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Gamma” SHPK.
 9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK.
 10. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

